

Fillimi > -Kronikë

EMRAT/ Arrestohen 4 persona në Krujë, si e vodhën biznesmenin dhe e kërcënuan me armë të tërhiqte kallëzimin. Policia zbulon se...

22 Gusht, 2023 12:13



Madhësia e tekstit: - +



KRUJË



Elton Babasi, Altin Hima, Aurel Hasa dhe Sadri Hima janë arrestuar nga policia e Krujës pasi akuzohen se kanë kërcënuar me armë një biznesmen.

Sipas burimeve zyrtare, 4 personat e kanosën me armë zjarri, pronarin e një biznesi, që të tërhiqte kallëzimin për njërin nga të arrestuarit, për vjedhje në biznesin e tij.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Krujë, pas marrjes së njoftimit për një konflikt me armë zjarri, në lagjen “Kastrioti”, Fushë Krujë, menjëherë kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar “Step by step”, për parandalimin e përkallëzimit të mëtejshëm të konfliktit.

Në kuadër të këtij operacioni u bë arrestimi i shtetasve:

– Elton Babasi, 25 vjeç, Altin Hima, 18 vjeç, të dy banues në fshatin Zallë; Sadri Hima, 42 vjeç dhe Aurel Hasa, 18 vjeç, të dy banues në Borizanë.

Shtetasi Sadri Hima dyshohet ka vjedhur në një biznes (njësi tregtare makinash), në pronësi të shtetasit B. H., i cili ka bërë kallëzim në Polici, për këtë shtetas. Më pas, shtetasi S. H., bashkë me 3 shtetasit e tjerë të arrestuar, ka kanosur me armë zjarri shtetasin B. H., për të tërhequr kallëzimin.

Gjithashtu, nga veprimet hetimore dyshohet se shtetasi S. H. ka kultivuar bimë narkotike që janë gjetur në fshatin Picrragë.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan 1 armë zjarri pistoletë, 1 armë gjahu çifte, 2 celularë dhe bimët e dyshuara narkotike kanabis.


Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme procedurale.

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Grabitën dhe kërcënuan me armë biznesmenin në Krujë, reagon Balla: Do bëjmë gjithçka që të mos ketë feude apo bajraqe

Etiketa: biznesmeni kercenim kruje policia

TË NGJASHME



"Çmendet" 34-vjeçari, qëllon me kallashnikov një banesë dhe i rrezikon jetën një familjeje, arrestohet

22 Gusht, 2023



Grabitën dhe kërcënuan me armë biznesmenin në Krujë, reagon Balla: Do bëjmë gjithçka që të mos ketë feude apo bajraqe


22 Gusht, 2023

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



Shkoi të rrëmbente vajzën që donte, pasi familja nuk pranoi zbrazti kallashnikovin drejt banesës, zbardhen detaje nga ngjarja në Skrapar

Eneida Petova | 22 Gusht, 2023



Mashtroi 200 koreanë dhe përfitoi 28 mln euro, 61-vjeçari gjerman kërkon lirinë kundrejt garancisë pasurore, ja çfarë vendosi gjykata

22 Gusht, 2023




EMRAT/ Goditi me sende të forta një burrë dhe një grua në Delvinë, shpallet në kërkim 32-vjeçari

22 Gusht, 2023



"Veprim i çmendur", BMW me shpejtësi skëterrë hipi mbi digë, eksperti rrugor: Mund të ketë qenë nën efektin e narkotikëve ose...

22 Gusht, 2023



Aksidenti te diga e liqenit në Tiranë/ "Me shpejtësi mbi 250 km/h", gazetari: Shoferi u pa të largohej i lënduar nga vendngjarja


22 Gusht, 2023



Gjestë të pahijshme në tribunë, thellohet skandali rreth Rubiales, vjen dhe denoncimi i parë


22 Gusht, 2023

KATEGORIA VIDEO



Koncesioni i sterilizimit/ "Asgjë nuk është bërë pa bekimin e Ramës dhe Beqjat", Vokshi: Ish-ministri kërkon të kapet pas fjes së kashtës, por...

22 Gusht, 2023




Mashtroi 200 koreanë dhe përfitoi 28 mln euro, 61-vjeçari gjerman kërkon lirinë kundrejt garancisë pasurore, ja çfarë vendosi gjykata

22 Gusht, 2023



"Veprim i çmendur", BMW me shpejtësi skëterrë hipi mbi digë, eksperti rrugor: Mund të ketë qenë nën efektin e narkotikëve ose...

22 Gusht, 2023



Aksidenti te diga e liqenit në Tiranë/ "Me shpejtësi mbi 250 km/h", gazetari: Shoferi u pa të largohej i lënduar nga vendngjarja

22 Gusht, 2023



Gjestë të pahijshme në tribunë, thellohet skandali rreth Rubiales, vjen dhe denoncimi i parë

22 Gusht, 2023



Nga "Rruga e Kosovarëve" fluturon mbi digë, Veliaj publikon videon e aksidentit: Dënimin maksimal për shoferin!

22 Gusht, 2023

